



Република Северна Македонија
НАРОДЕН ПРАВОВАНИТЕЛ
Republika e Maqedonisë së Veriut
AVOKATI I POPULLIT
Republic of North Macedonia
O M B U D S M A N

Më datë **20.09.2018**, Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizitë të rregullt të paparalajmëruar në Stacionin Policor për Kontrolle Kufitare dhe Mbikëqyrje Kufitare (SP për KK dhe MK) Star Dojran.

Vizita u realizua konform mandatit të Avokatit të Popullit, - Mekanizmi Parandalues Nacional i përcaktuar në Protokollin Fakultativ ndaj Konventës Kundër Torturës dhe Veprimeve tjera Brutale, Johumane, Përçmuese ose Ndëshkuese, me qëllim të përcaktimit të gjendjes reale, përkatësisht gjendjes objektive dhe kushteve në këtë Stacion Policor, në drejtim të identifikimit të rreziqeve me qëllim të parandalimit të torturës ose llojeve tjera të veprimit brutal, jonjerëzor, përçmues ose ndëshkues.

Vizita në SP për KK dhe KM Star Dojran filloi me bisedën me eprorit të Stacionit Policor, të cilit iu prezantua mandati dhe kompetencat e Mekanizmit Parandalues Nacional, u bë këqyrje në hapësirat zyrtare dhe atyre ndihmëse, këqyrje në dosjet individuale të personave të arrestuar, të privuar nga liria dhe personave të ndaluar, si dhe në regjistrat të cilët mbahen në Stacionin Policor (Regjistri për ngjarjet e ditës, për personat e thirrur, personat e paraburgosur dhe të ndaluar).

Ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional pati mundësi të realizoj këqyrje në librat e evidencës, me ç'rast konstatoi se ka mangësi në aspektin e mbajtjes së regjistrave, azhurnimit të pamjaftueshëm, mungesës së të dhënave në rubrika të caktuara dhe korrigjimeve të kryera me llak korrektues.

Gjatë vizitës, nga ana e ekipit të MPN në zyrën e zëvendës-eprorit u vërejt një shufër-gome-shkop policie, që do të mund të kishte efekt frikësues ndaj personave me të cilët zhvillojnë biseda ose ndaj të cilëve bëhet kontrolli.

Ekipi i MPN konstatoi se në SP për KK dhe MK Star Dojran zbatohen dhe organizohen trajnime të vazhdueshme me përmbajtje të ndryshme tematike, ndërsa një pjesë e nëpunësve më me përvojë policore mbajnë trajnime si mentorë.

Ekipi i MPN u informua se në Stacionin Policor për KK dhe MK Star Dojran nuk ka hapësira të posaçme për marrje në pyetje dhe kontroll të personave të arrestuar dhe personave të privuar nga liria. Në hapësirat të cilat shfrytëzohen për kryerjen e kontrollit dhe zhvillimin e bisedave me personat e ndaluar përkohësisht, nuk janë theksuar postera përkatës me udhëzime për të drejtat e personave në gjuhë të huaj.

Ekipi i MPN konstatoi se në këtë Stacion Policor në Regjistrat për evidencë, ka mangësi gjatë plotësimit të një pjese të rubrikave, si dhe përdoret llaku korrektues.

Për vizitën, Mekanizmi Parandalues Nacional hartoi Raport të posaçëm në të cilin i konstatoi gjendjet pozitive dhe negative dhe dërgoi rekomandime konkrete deri te Ministria e Punëve të Brendshme, si dhe deri te eprori i Stacionit Policor, me qëllim që të eliminohen mangësitë e theksuara dhe të përmirësohen kushtet dhe veprimi me personat e privuar nga liria, personat e paraburgosur dhe personat e ndaluar.